



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. dokumentit: 21.19.1-2011-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË UNIVERSITETIT TË
PRISHTINËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2011

Prishtinë, Qershor 2012

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave.....	4
Përmbledhje e përgjithshme	5
1 Hyrje.....	7
2 Opinioni i auditimit	8
3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar	9
4 Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar	9
5 Pasqyrat vjetore financiare – Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit.....	11
6 Menaxhimi financiar.....	12
6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake).....	12
6.2 Shpenzimet.....	14
6.3 Pasuritë	22
6.4 Trajtimi i borxheve	22
6.5 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor	24
7 Kontrolli menaxherial.....	25
7.1 Sistemet e kontrollit të brendshëm	25
7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm	26
8 Një konkluzion i përgjithshëm mbi menaxhmentin e UP-së.....	27
Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	29
Shtojca II: Rekomandimet e vitit të mëhershëm	31

Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
AQ	Administrata Qendrore
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KPM	Komisioni i Pavarur Mbikëqyrës
KRPP	Komisioni Regullativ i Prokurimit Publik
LMFPP	Ligji 03/L-48 për Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji për Prokurimin Publik nr. 03/L-241 i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-042 në fuqi prej 05.10.2011.
MF	Ministria e Financave
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
UA	Udhëzim Administrativ
UP	Universiteti i Prishtinës
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Universitetit të Prishtinës (UP) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga INTOSAI (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë pasqyrat vjetore financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj lidhur me kontrollet të pamjaftueshme për të hyrat vetjake, që rezultuan në diferenca në mes vlerave në fletëpagesat e lëshuara nga bankat komerciale dhe shumave faktike të deponuara në llogarinë bankare të UP.

(SNISA 400: Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes)

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë të përshkruara më detajisht në brendi të raportit.

Konkluzioni ynë është që sistemi i kontrolleve të brendshme të UP nuk është dizajnuar në mënyrë të përshtatshme për të eliminuar dobësitë ekzistuese si dhe nuk po zbatohet si duhet. Kjo do të duhej të adresohet për të përmirësuar performancën administrative dhe financiare të organizatës.

Rekomandimi ynë i përgjithshëm është që Rektori i UP-së të sigurojë:

- Revitalizimin e qasjes së përgjithshme të MFP-së. Mjeti i vetëvlerësimit të Qeverisë për MFP shërben si pikënisje për Planin e Veprimit për adresimin e dobësive të përcaktuara;
- Organizimin e një projekti për implementimin e Planit të Veprimit. Të caktohet një menaxher i projektit. Menaxheri i Projektit ti raportoj drejtpërdrejtë Rektorit;
- Plani i Veprimit duhet të jetë Specifik, i Matshëm, i Arritshëm, Relevant dhe me Kohë (modeli SMART).

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe i kontrolleve të brendshme në afat sa më të shkurtër, ne rekomandojmë Rektorin e UP-së që veçanërisht të sigurojë:

- Adresimin e të gjitha rekomandimeve të ngritura nga auditimi;
- Vendosjen e Kontrolleve të duhura dhe të mjaftueshme në lidhje me procesin e harmonizimit të të hyrave ndërmjet të Administratës Qendrore dhe Njësive Akademike të cilët mbledhin të hyra;
- Forcimin e kontrolleve mbi procesin e prokurimit dhe certifikimit, përdorimit të subvencioneve dhe obligimeve të papaguara;
- Rifreskimin e procedurave dhe kontrolleve në Burimet Njerëzore si dhe transparencë gjatë pagesave për punën jashtë orarit;
- Vendosjen e kontrolleve të duhura në lidhje me menaxhimin e detyrimeve të papaguara dhe shpalosjen korrekte të tyre;
- Një menaxhim më efektiv dhe regjistrim të plotë të pasurisë jo financiare; dhe
- Fuqizimin e mëtejshëm të Komitetit të Auditimit.

Menaxhmentit të UP-së i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti.

Menaxhmenti i UP-së është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2011, dhe është zotuar që do të bëjë përpjekje për t'i adresuar të gjitha rekomandimet.

1 Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me pasqyrat vjetore financiare të UP për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e UP të përgatisë pasqyrat vjetore financiare sipas kërkesave të Rregullës Financiare Nr. 07/2011 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për “ Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme ”.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë për UP.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat vjetore financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Në tremujorin e fundit të vitit 2011, kemi kryer auditimin e ndërmjetëm të UP. Gjatë asaj faze të auditimit, kemi adresuar faktin se si janë trajtuar rekomandimet e mëparshme si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Po ashtu, kemi këshilluar menaxhmentin lidhur me hartimin sa më cilësor të pasqyrave vjetore financiare. Një Memorandum i auditimit, lidhur me këtë është dorëzuar në dhjetor 2011.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë tona për auditimin e UP-së, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar pasqyrat vjetore financiare të UP-së në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2011;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat vjetore financiare janë përgatitur në pajtim me SNSKP “ Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme ”;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;

- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Kemi kryer vlerësimin e kontrolleve të brendshme dhe testimin e tyre sipas nevojës;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në UP.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare 2011.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të UP-së, Standardet Ndërkombëtare të auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 1.

2 Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat vjetore financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj lidhur me kontrollet të pamjaftueshme për të hyrat vetjake, që rezultuan në diferenca në mes vlerave në fletëpagesat e lëshuara nga bankat komerciale dhe shumave faktike të deponuara në llogarinë bankare të UP.

(SNISA 400: Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes)

3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar

Në raportin tonë të auditimit të pasqyrave vjetore financiare për vitin 2010 janë dhënë tetë rekomandime kryesore. UP, ka miratuar një Plan Veprimi i cili i adreson rekomandimet e dhëna nga raporti i auditimit për vitin financiar 2010.

Në të njëjtën kohë ne kemi vërejtur se zbatimi aktual i Planit Veprues deri tani ishte në proces të ngadalësuar. Prej tetë rekomandimeve të dhëna, katër ishin në proces e sipër dhe katër të tjera nuk ishin adresuar. Mos adresimi i plotë i rekomandimeve tona të mëhershme, kanë shkaktuar probleme të ngjashme sikur në vitin 2010.

4 Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Vjetore Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1 Burimet e fondeve Buxhetore - aktuali ndaj buxhetit (në €)

Burimet e fondeve	Buxheti Fillestar	Buxheti Final ¹	Të shpenzuara 2011	Të shpenzuara 2010
I. Gjithsej:	15,608,698	26,249,403	24,576,014	23,690,772
Granti i Qeverisë - buxheti	15,608,698	15,604,574	14,968,341	15,016,737
Të bartura nga viti i kaluar ²	-	718,828	689,354	-
Të hyrat vetjake	-	8,906,314	8,475,287	8,443,643
Donacionet e vendit	-	5,050	3,500	-
Donacionet e jashtme	-	1,014,637	439,532	230,392

Në tabelën 1, shihet se buxheti final ishte për 10,640,705€ më i lartë se sa buxheti fillestar. Diferenca ka të bëjë me të hyrat vetjake dhe donacionet që nuk kanë qenë të përfshira në procesin e buxhetit fillestar.

¹ Buxheti Final- buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

² Të hyrat vetjake të pa shpenzuara në vitin e kaluar dhe të bartura në vitin aktual.

Tabela 2 Shpenzimi i fondeve sipas kategorive ekonomike - aktualit ndaj buxhetit(në €)

Shpenzimi i fondeve	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Të shpenzuara 2011	Të shpenzuara 2010
Gjithsej shpenzimet	15,608,698	26,249,404	24,576,014	23,690,772
Paga dhe Mëditje	9,617,755	18,041,433	17,797,469	17,357,598
Mallra dhe shërbime	3,604,040	4,497,217	3,543,985	3,270,797
Shpenzimet komunale	1,145,421	1,145,421	1,048,754	999,253
Subvencionet dhe transferet	-	1,327,975	1,028,864	900,149
Investimet Kapitale	1,241,482	1,237,358	1,156,942	1,162,975

Në tabelën 2 janë të paraqitura shpenzimet në raport me buxhetin final. UP ka shpenzuar 24,576,014€ apo 94% nga buxheti final. Pagesa e një detyrimi të bërë direkt nga Thesari në bazë të vendimit gjyqësor, ka qenë kontest i filluar nga viti 2008. Kjo ka dëmtuar buxhetin e UP-së në vlerë prej 677,832€. Njëkohësisht, kjo ka sjellë UP në vështirësi financiare në realizimin e objektivave të planifikuara.

Pjesa më e madhe e buxhetit apo 72% është realizuar për paga dhe mëditje.

Buxheti i pa shpenzuar në fund të vitit 2011 ishte 1,673,390€. Nga kjo, shuma prej 576,655€ apo 34.5% janë fonde të donacioneve. Fondet e pa shpenzuara nga të hyrat vetjake dhe donacionet bartën për shfrytëzim në vitin 2012.

Shfrytëzimi në nivel të ulët i donacioneve ishte për shkak se koha e realizimit të donacioneve varej nga programet e donatorëve. Te kategoria e investimeve kapitale nuk kishte realizim racional gjatë tërë vitit. Vetëm në dy mujorin e fundit ishin shpenzuar rreth 58% e buxhetit për investime kapitale.

Konkluzioni

Sfida kryesore e vërejtur në fushën e ekzekutimit të buxhetit ishte shpenzimi i donacioneve. Gjithashtu, pagesat për detyrime kontingjente, kanë krijuar vështirësi në arritjen e projekteve të planifikuara. Këto shpenzime nuk ishin marrë në konsideratë nga UP me rastin e planifikimeve buxhetore.

Shpenzimi i buxhetit për investime kapitale prej 58% vetëm në dy mujorin e fundit, si dhe mos planifikimi i mirë i rrjedhë së parasë, ishin karakteristikat kryesore të ecurive buxhetore.

Rekomandimi 1

Rekomandojmë Rektorin e UP të siguroj:

- Planifikimin, monitorimin dhe shfrytëzimin e buxhetit, duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët që kanë ndikim në çështjet buxhetore, duke u bazuar në rrjedhën e parasë dhe alokimin e shpenzimeve në baza tremujore; dhe
- Forcimin e kontrollit në menaxhimin fondeve për investimet kapitale, për të arritur efikasitet më të madh në realizimin e kontratave në afatet e caktuara.

5 Pasqyrat vjetore financiare – Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit

Bazuar në kërkesat e LMFPP nr. 03/L-048 dhe Rregullës Financiare nr. 07/2011, konkludojmë se:

- PVF janë përgatitur në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme";
- P/F janë dorëzuar në MF/Thesar më 2 Shkurt 2012. Për shkak të gabimit në nenin 13 të P/F, ato janë korigjuar dhe dërguar në Thesar pas afatit të paraparë;
- PVF janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar; dhe
- PVF janë përgatitur vetëm në gjuhën Shqipe.

Konkluzioni

Versioni i parë i Pasqyrave financiare të UP përmbante disa mangësi, (informata mbi prezantimin e buxhetit final) dhe ne kemi këshilluar menaxhmentin e UP-së që ato të korigjohen. Pasqyrat Financiare të UP pas kërkesës sonë, gjatë procesit të auditimit, janë korigjuar dhe dërguar për herë të dytë në Thesar.

UP duhet të ndërmarr të gjitha masat e duhura drejt sigurimit të informatave nga njësitë e saj, të bëjë konsolidimin e tyre dhe pastaj të bëjë shpalosjen e tyre në PVF.

6 Menaxhimi financiar

6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)

UP për vitin 2011 kishte planifikuar të hyra vetjake në shumën prej 8,906,314€, ndërsa të hyrat e bartura nga viti i kaluar ishin prej 718,828. Sipas SIMFK, shumata e mjeteve të inkasuara për vitin 2011 ishte 9,291,198€.

Të hyrat vetjake UP i realizon kryesisht nga participimet për shkollim (tarifat e shkollimit dhe pagesat e tjera administrative), kontratat me entitete vendore, ndërkombëtare, publike dhe private për mësimdhënie, kërkime shkencore, punë artistike dhe konsulta, si dhe të hyrat e tjera në përputhje sipas rregullave të parapara.

Sipas memorandumit të mirëkuptimit në mes të MF dhe UP-së, parashihet që të gjitha të hyrat vetjake të inkasuar dhe të bartura, të shfrytëzohen nga UP.

Shfrytëzimi i të hyrave të mbledhura do të bëhet për: kategorinë paga dhe mëditje 8,310,215€ dhe 1,314,927€ për kategorinë e Subvencioneve (shumata e mjeteve për kategorinë e subvencioneve do të përdoret për bursa të studentëve). Shpenzimi i të hyrave vetjake ishte 9,164,641€, apo 99% nga vlera e realizuar.

Kemi bërë vlerësimin dhe rishikimin e procedurave mbi realizimin e të hyrave vetjake. Kemi testuar funksionimin e procesit të mbledhjes së të hyrave nga regjistrat kontabël deri në dokumentacionin burimor. Ne kemi kryer testimin e 215 fletëpagesave në katër Njësi Akadematike në vlerë prej 29,855€.

Është vërejtur mos përputhje ndërmjet vlerave në fletëpagesa (të lëshuara nga banka komerciale) dhe shumave faktike të deponuara në llogarinë bankare të UP. Këtë e kemi vërejtur në 34 raste të transaksioneve.

Në 30 raste, vlera e prezantuar në fletëpagesën e lëshuar nga banka për paguesin (studentin) ishte 250€, dhe në dy raste nga 50€, ndërsa në llogarinë bankare të UP, shumata faktike të deponuara ishin vetëm nga 5€ për transaksion. Në rastin tjetër, në fletëpagesë ishte e prezantuar shumata prej 300€ ndërsa në llogarinë bankare të UP ishin deponuar vetëm 3€. Vetëm nga këto raste, është inkasuar më pak afërsisht vlera prej 8 mijë euro.

Në datën 21 Maj 2012, çështjet e theksuara lidhur me mospërputhjet e shumave në fletëpagesa dhe raporteve bankare i kemi diskutuar me zyrtarët e Raiffeisen Bank, për të verifikuar se ku mund të jenë gabimet. Pas verifikimit të raporteve bankare, kemi ardhur në përfundim se fletëpagesat e lëshuara nga banka janë dhënë në shumata 3 ose 5 € (aq sa

edhe janë inkasuar). Këto fletëpagesa me numra dhe emra të njëjtë të kandidatëve më vonë në UP janë dorëzuar me shuma të paguara 50, 250 apo 300€.

Ne nuk jemi në gjendje ta konfirmojmë se cilat dokumente duhet të konsiderohen si të sakta dhe nga kush janë bërë këto veprime, por duket qartë se dyshimet e bazuara për mashtrime ekzistojnë.

Nga kjo shihet se 15% të pagesave nga mostra e testuar, kanë rezultuar me gabime të dyshuara si të qëllimshme.

Mungesa e një softueri për regjistrimin e të hyrave

UP nuk posedon një softuer për evidentimin dhe raportimin e të hyrave i cili do të mundësonte një raportim më real të gjendjes financiare. Posedimi i një programi të tillë do të ishte një masë preventive. Kjo do të kishte efekt parandalues të keqpërdorimeve të mundshme me rastin e pagesës së participimeve të studentëve.

Mosbarazim i të hyrave në mes të Administratës Qendrore (AQ) dhe Njësive akademike.

UP nuk ka arritur që të bëjë harmonizimet për të hyrat vetjake në mes të AQ dhe njësive të veta akademike ku është edhe burimi i këtyre të hyrave. AQ shënimet për këto të hyra, përpos nga njësitë e veta akademike, i siguron nga Thesari dhe BQK.

Konkluzioni

Mungesa e një softueri për të hyra në UP kishte ndikim në regjistrim dhe raportim. Informatat aktuale mbi të hyrat nuk ishin të sakta, të plota dhe të raportuara me kohë.

Ndryshimet në mes raporteve bankare dhe gjendjes së prezantuar të të hyrave nga UP paraqesin kontrolle jo adekuate. Gjendja ekzistuese e disa pagesave ngrit dyshime të bazuara mbi mashtrimet. Menaxhmenti i UP-së duhet të merr masa të menjëhershme që t'i sqaroj rastet e dyshuara.

Rastet e gjetura janë dërguar në Prokurori. Ekziston nevoja për një studim më të thellë për të gjitha pagesat e bëra, harmonizim të vlerave dhe të ndërmerren masa sipas nevojës.

Mos harmonizimi i të hyrave në baza mujore ndërmjet njësive akademike dhe administratës qendrore të UP-së, bën të pa mundur pasqyrimin e plotë dhe të saktë të të hyrave. Kjo lë të hapur mundësinë e mos zbulimit me kohë të keqpërdorimit të mundshëm dhe vështirëson vendim marrjen e menaxhmentit.

Rekomandimi 2

Rekomandojmë Rektoren e UP të siguroj:

- Që regjistrimi dhe monitorimi i të hyrave do të bëhet përmes zhvillimit të një programi të përshtatshëm softuerik, ku mundësia e shfaqjes së diferencave do të reduktohet në nivel minimal dhe kontrollet do të jenë më efektive;
- Të listohen të gjithë kandidatët të cilët kanë bërë pagesa më pak sesa duhej të bënin, dhe të njëjtit t'i bëjnë pagesat në shuma të plota, ashtu siç është përcaktuar me rregulloret e UP. Kontrollet e verifikimit të këtyre pagesave, në të ardhmen të jenë të përshtatshme, për të mos u përsëritur praktikatat e tilla;
- Analizimin e gjendjes së krijuar nga auditimi i brendshëm lidhur me pagesat e studentëve; dhe
- Harmonizimet në baza mujore për të hyrat vetjake në mes administratës qendrore dhe të njësive akademike, si dhe harmonizimet në mes të AQ-Thesarit dhe BQK.

6.2 Shpenzimet

6.2.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

UP për vitin 2011 për këtë kategori kishte planifikuar një shumë prej 18,041,433€. Nga shuma e planifikuar, UP kishte shpenzuar 17,797,469€ apo 98 %.

Me rastin e rishikimit të procedurave të shpenzimeve, ne kemi identifikuar dobësitë si në vijim:

Zyrtarë me dy Kontrata të rregullta pune

Sipas legjislacionit në fuqi dhe Rregullores së brendshme të UP, zyrtarët kanë të drejtë të nënshkruajnë vetëm një kontratë të rregullt pune.

Në dy raste, UP kishte nënshkruar dy kontrata të rregullta pune me të njëjtin zyrtarë. Bazuar në këto kontrata, janë kryer edhe pagesat për pagë primare si profesor të rregullt. Në të njëjtën kohë, me të njëjtin ka kontraktuar punë në pozita drejtuese, duke e paguar me pagë sekondare. Në rastin tjetër, zyrtari që udhëheq një Këshill në UP, merr pagesa shtesë edhe si anëtar i atij Këshilli.

Rastet e tilla nuk janë në pajtim me Rregulloren Nr. 2/608 për të ardhurat personale në Universitetin e Prishtinës.

Kontratat mbi Vepër

Ne testuam 11 raste, ku gjatë vitit 2011 UP kishte lidhur kontrata mbi vepër (të përkohshme) në vlerë prej 31,648€ jashtë procedurave të konkursit.

Kompensimi i zyrtarëve për orët jashtë orarit

Ne kemi testuar gjashtë raste për zyrtarët të cilët kishin punuar jashtë orarit të punës.

Ne një rast merret Vendimi mbi lartësinë e kompensimit personelit të Rektoratit të UP-së për shtimin e vëllimit të punëve, obligimeve dhe përgjegjësi me rastin e pranimit të studentëve të ri në vitin akademik për afatin e studimeve Master 2011/12. Në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues, Rektoratit nga çdo pagesë e studentit, i takojnë 20% të shumave të inkasuara.

Në afatin e dytë gjithsej kanë aplikuar 13926 studentë dhe janë grumbulluar 139,260€. Në bazë të këtij vendimi, zyrtarëve të Personelit të Administratës Qendrore për angazhimet e tyre iu është kompensuar shumën në total prej 27,852€. Në bazë të këtij vendimi janë paguar gjithsejtë 54 zyrtarë të cilët janë paguar sipas pozitës përkatëse.

Po ashtu, ne testuam pagesat për pesë raste individuale në një vlerë prej 7,185€ për zyrtarët e UP-së të cilët kanë punuar jashtë orarit.

Në rastet e përmendura, që kishin të bënin me kompensimet për punë shtesë, gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se nuk ka transparencë të mjaftueshme. Mungojnë raportet apo dëshmitë mbështetëse për punën e kryer jashtë orarit.

Kompensimi për orët mbajtura nga Personeli Akademik

Ne kemi testuar 12 raste për vijueshmërinë e ligjëratave nga Personeli Akademik dhe kryerjen e pagesave në bazë të kontratave. Në tri raste u janë bërë ligjëruesve pagesa edhe pse nuk i kishin plotësuar normën e paraparë me kontratë (ishin të planifikuara 24 orë në muaj, ndërsa kishin mbajtur vetëm nga 18 orë). Sipas Rregullores për të ardhura personale në UP, Personeli Akademik i cili mungon nga procesi mësimor, sanksionohet me heqje të pjesshme të pagës dhe atë 50€ për çdo orë të humbur të ligjëratës. Veprime të tilla nuk janë ndërmarrë nga ana e menaxhmentit.

Kemi analizuar pagat vjetore të paguara në bazë të sistemit të Payrollit dhe kemi vërejtur tejkalime nga paga bazë (sipas kontratës së rregullt).

Këto ndryshime janë si rezultat i pagesave të tjera për: shtesat, honorarët, si dhe pagesat mbi normë. Ndonëse shtesat janë të përcaktuara në bazë të Rregullores së UP-së, megjithatë marrë në konsiderim tejkalimin e pagës bazë, ato duhet të rishikohen në aspektin e limiteve të caktuara.

Konkluzioni

Lidhja e kontratave pa një bazë të qartë juridike me vet zyrtarët e UP-së, anashkalimi i procedurave të hapura të konkursit të kontratave mbi vepër, kompensimi pa dëshmitë mbështetëse për punën e kryer jashtë orarit, vijueshmëria jo e rregullt në ligjëratat nga Personeli Akademik janë rezultat i kontrolleve të brendshme të pa mjaftueshme.

Disa nga këto dukuri janë përsëritur edhe nga viti i kaluar, por përkundër rekomandimit tonë, UP nuk ka ndërmarrë veprime të përshtatshme. Rregullsia e këtyre pagesave është e pa qartë dhe jo transparente. Gjithashtu, mungesa e raporteve dhe evidencave për punët e kryera jashtë orarit rrit mundësinë për pagesa fiktive.

Rekomandimi 3

Rekomandojmë Rektoren e UP të siguroj:

- Rishikimin e politikave për paga dhe aplikimin e tyre bazuar në procedura dhe vlera të legjislacionit për shërbyesit civil;
- Kontraktimin me kontrata të rregullta pune mbi bazën juridike;
- Rritjen e mbikëqyrjes mbi vijueshmërinë e ligjëratave nga ana e personelit akademik; dhe
- Kontrollin e raportimit dhe raporte të sakta të mbahen nga secili departament për punët që janë kryer si rezultat i aktiviteteve jashtë orarit të rregullt të punës.

6.2.2 Prokurimi

Investimet kapitale

Për këtë kategori ishte planifikuar buxheti në vlerë prej 1,237,358€, prej të cilave janë shpenzuar 1,156,942€ apo 94%.

Ne kemi testuar pagesat dhe procedurat e ndërmarra të prokurimit dhe kemi marrë për testim 16 njësi mostre në një vlerë prej 373,244€ apo 32% të vlerës totale të shpenzimeve.

Bazuar në ekzaminimet tona kemi vërejtur se UP ka ndërmarrë procedura të prokurimit të cilat janë përcjellë me dobësi dhe mangësi përkatëse. Në pjesën në vijim, po paraqesim dobësitë e identifikuar:

Eliminimi i operatorit me çmim më të lirë

Tek lënda "Furnizim me pajisje speciale Mjekësore për Fakultetin e Mjekësisë", nuk është përzgjedhur operatori me çmim më të lirë (sipas kriterit çmimi më i lirë). Komisioni për Vlerësim ka eliminuar operatorin me çmim më të lirë se fituesi për 13,444€.

Lidhja e kontratave në mungesë të zotimit të mjeteve, sigurimit të ekzekutimit të kontratës dhe mos aplikimi i penaleve për mos kryerjen e punimeve në afatin e paraparë

Tek kontrata "Renovimi i Amfiteatrit në fakultetin Ekonomik dhe Juridik" në vlerë prej 128,610€ është bërë zotimi vetëm në vlerën prej 70,000€.

Tek lënda "Furnizim me pajisje speciale Mjekësore për Fakultetin e Mjekësisë" vlefshmëria e sigurimit të ekzekutimit të projektit kishte skaduar. Po ashtu, Liferimi i pajisjeve ishte bërë me vonesë në afat prej 166 ditë.

Tek lëndët: "Ndërtimi i Objektivit të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj" në vlerë prej 1,756,866€ dhe "Furrë për përpunimin termik 1280°C" në vlerë prej 16,385€, nuk kishin përfunduar punimet sipas planit dinamik.

Pagesa e Avansit

Me datën 23.12.2011 është paguar avans OE që ishte fitues i projektit "Ndërtimi i Amfiteatri për nevojat e fakultetit të UP-së në Gjilan" në vlerë prej 17,000€. Ky projekt kishte vlerë kontraktuese 113,265€. Sipas UA 11/2011 (për përfundimin e vitit fiskal 2011) ndalohet pagesa e çfarëdo avansi në muajin Dhjetor, i cili kalon 5% të vlerës së kontratës.

Kryerja e shërbimeve me OE dhe pagesave, edhe pas skadimit të kontratës

Nga data 02.03.2011 kishte përfunduar kontrata me OE për kryerjen e shërbimeve "Pastrimi i objekteve të UP-së". Me vendim të Rektorit OE kishte vazhduar kryerjen e shërbimeve deri në nënshkrimin e kontratës tjetër. Vlera e pagesave pa kontratë, deri në nënshkrimin e kontratës tjetër me datën 24.08.2011, ishte prej 213,888€.

Konkluzioni

Përzgjedhja e ofertuesit me çmim më të lartë, vonesat në liferimin e mallrave, kontratat pa siguri ekzekutimi, çështja e avanseve, hyrja në obligime kontraktuese pa sigurimin e fondeve, kryerja e shërbimeve nga OE me kontratë të skaduar, dhe mos aplikimi i penaleve në raste të mos përfundimit të punimeve sipas planit dinamik, tregojnë se menaxhmenti i UP-së i ekspozohet rrezikut të vazhdueshëm të keq-menaxhimit të fondeve publike.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë Rektoren e UP të siguroj:

- Forcimin e kontrolleve lidhur zhvillimin e proceseve të prokurimit në përgjithësi, dhe me kontrata të shpërblehen operatorët më konkurrent dhe më të favorshëm;
- Ekzistojnë fondet e mjaftueshme për realizimin e projekteve të kontraktuara;
- Aplikon penalet sipas kontratave, për mos liferimin e mallrave me kohë ndaj të gjithë OE;
- Të zhvillojë politika dhe procedura për t'u siguruar që cila do kompani që do të marrë kontratën, të ofrojë sigurimin e ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës; dhe
- Se të gjitha pagesat bëhen vetëm në pajtim me vlefshmërinë e kontratave.

6.2.3 Blerjet tjera

Shpenzimet e përgjithshme për mallra dhe shërbimeve ishin në vlerë prej 4,592,739€ apo 69% nga ato të buxhetuara. Në këtë fushë, ne kemi marrë për testim vetëm mostrat që përfshin pagesat jashtë procedurave të prokurimit. Kemi testuar 48 mostra në vlerë prej 864,249 €. Ekzaminimet tona kanë shpalosur disa dobësi që prezantohen si në vijim:

Kryerja e pagesave për shërbime dhe furnizime pa procedura të prokurimit

Ne kemi testuar pagesat lidhur me lëndën , blerja e dhuratave me rastin e festës së gruas, “8 Marsi” në vlerë prej 4,504€, si dhe për shpenzimet e akomodimit me rastin e organizimit për kursin “Lënda e skijimit” në vlerë prej 37,813€. Këto pagesa janë kryer pa u zhvilluar procedura të prokurimit. Projekti “Lënda e skijimit” është dashur dhe është realizuar në muajin Shkurt 2012. Derisa aprovimi i Buxhetit të Kosovës është bërë në fund të muajit Mars 2012, që sipas UP-së qëndronte edhe arsyeja.

Tejkalim të limitit të përcaktuar për shpenzimet e telefonisë fikse.

Testimi i mostrave dhe rishikimi i raporteve për shpenzimet e telefonisë fikse ka treguar tejkalim të shpenzimeve nga limitet e përcaktuara prej 4,148€. Limitet e telefonisë fikse janë të përcaktuara në bazë të Rregullores së brendshme të UP-së. Kjo Rregullore është e pa harmonizuar me UA 04/2008 mbi shpenzimet e telefonit.

Në disa raste janë aplikuar masat ndëshkuese, në bazë të një vendimi për shkak të tejkalimit të shumës mujore të përcaktuar me rregulloren e brendshme për përdorimin e telefonave fiks.

Në muajin tetor 2011 për shkak të tejkalimit të shumës mujore të përcaktuar me rregullore zyrtarëve të UP-së do t'u bëhet ndalesa nga paga. Ky vendim ishte zbatuar vetëm për një muaj, ndërsa edhe në muaj të tjerë ka pasur tejkalime dhe nuk janë aplikuar ndalesat.

Konkluzioni

UP ende nuk ka arrit të vendos kontrole efektive mbi shpenzimet. Mos aplikimi i procedurave të prokurimit për shërbimet dhe furnizimet përkatëse, i bën të pamundur blerjet më të favorshme dhe më të lira.

UP nuk ka praktikuar një kontroll të vazhdueshëm, në mënyrë që të parandalojë mbishpenzimet për telefonin fikse.

Rekomandimi 5

Rekomandojmë Rektorin e UP të siguroj:

- Kontroll të shtuar lidhur me shpenzimet si në aspektin procedural, po ashtu edhe në atë financiar. Kontrollët duhet shtuar sidomos në rastet kur kërkohet aplikimi i blerjeve përmes prokurimit.

6.2.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për kategorinë e subvencioneve ishte 1,327,975€. Nga kjo shumë janë shpenzuar 1,028,864€ apo 77%.

Subvencionet që i paguhen një njësie të përcaktuar apo një ndërmarrje private duhet të bazohen në një marrëveshje zyrtare ndërmjet organizatës buxhetore dhe pranuesit të subvencionit.

Vlera më e madhe e subvencioneve është realizuar për bursat e studentëve, tek të cilat nuk kemi hasur ndonjë parregullsi. Ne kemi testuar tetëmbëdhjetë (18) raste që kapin vlerën totale prej 25,422€.

Pagesa e shpenzimeve për trajtime mjekësore

Sipas Marrëveshjes se Mirëkuptimit ndërmjet MF dhe UP, shuma prej 1,314,927€ e të hyrave vetjake të mbledhura do të përdoret në mënyrë eksplicite për bursa të studentëve. Në dy raste, nga kjo shumë parash, ne kemi vërejtur se janë bërë pagesa për trajtime mjekësore në vlerë prej 5,233€. Ky veprim nuk përshtatet me Memorandumin e Mirëkuptimit për shpenzimin e të hyrave vetjake.

Pagesa e Pagës sipas kontratës mbi kryerjen e shërbimeve të veçanta nga kategoria e Subvencioneve

Pagesa në vlerë prej 1,284€ ka të bëjë me angazhimin e zyrtarit në vendin e punës Laborante e Kimisë në departamentin e Farmacisë në Fakultetin e Mjekësisë. Një ndarje dhe pagesë e tillë e mjeteve nuk mund të klasifikohet si subvencion.

Konkluzioni

Përkundër rekomandimeve tona në vitet e kaluara, UP nuk ka arritur të vendosë kontrolle të mjaftueshme në menaxhimin e subvencioneve. Mos aplikimi i procedurave të qarta dhe kritereve të caktuara, rrit dyshimin se shpenzimet e subvencioneve janë në harmoni me destinimet.

Rekomandimi 6

Rekomandojmë Rektoren e UP të siguroj:

- Hartimin e një Udhëzuesi të brendshëm duke i specifikuar qartë të gjitha kushtet dhe kriteret mbi ndarjen e subvencioneve; dhe
- Respektimin e memorandumit të nënshkruar me MF.

6.2.5 Çertifikimi i pagesave dhe regjistrimet në kode jo adekuate

Përgjegjësia e zyrtarit çertifikues është të verifikoj procedurat për të përcaktuar nëse janë përmbushë kërkesat ligjore për autorizimin e pagesës.

Zyrtari çertifikues pritët që ta rishikojë në tërësi dokumentacionin mbështetës të secilës kërkesë për pagesë për të përcaktuar nëse të gjitha kontrollet e caktuara nga legjislacioni janë zbatuar si duhet.

Ne kemi identifikuar disa raste që kishin mangësi gjatë procesit të çertifikimit:

Dokumentacioni mbështetës jo i plotë

Me rastin e testimi të pagesës së faturës në vlerë prej 33,892€ të kompanisë “Termokos” sikur edhe në vitet paraprake mungojnë raportet nga Fakultetet për shërbime me ngrohje dhe të dhënat tjera. Mungesa e dokumenteve të kërkuara ka bërë të pa mundur verifikimin e saktësisë së pagesave për shpenzimet reale të ngrohjes nga të gjitha Njësitë Akadematike të cilat shfrytëzojnë shërbimet.

Tek lënda “Botimi i librave” në vlerë prej 18,194€ me rastin e pagesës nuk kishte dokument mbështetës për kryerjen e furnizimeve apo shërbimeve përkatëse, por janë paguar bileta të udhëtimit për nevoja zyrtare.

Te pagesa “Mirëmbajtja e ndërtesave” në vlerë prej 25,153€ nuk kishte dokument mbështetës për kryerjen e shërbimeve përkatëse, por janë paguar faturat për furnizim me material shpenzues.

Shpenzime të regjistruara në kode të gabuara ekonomike

Tek regjistrimi i shpenzimeve nëpër kode ekonomike kemi vërejtur se disa prej tyre ishin regjistruar në kode të gabuara. Rastet e identifikuara janë:

Tek lënda “Ndërrimi i dritareve në Fakultetin Ekonomik dhe Juridik” në vlerë prej 63,384€, pagesa është bërë nga kodi për mallra dhe shërbime, e jo nga kodi i Investimeve Kapitale.

Pagesa në vlerë prej 25,153€ është regjistruar në kodin për mirëmbajtjen e ndërtesave, kurse janë kryer furnizime me material shpenzues për zyre.

Tek lënda e regjistruar si “Mirëmbajtja e teknologjisë informative”, shpenzimi në vlerë prej 48,720€ ishte kryer për furnizimin me një pajisje për prodhimin e ID kartelave për nevojat e UP.

Tek lënda për furnizim me derivate të naftës për ngrohje dhe për gjenerator të UP, në këtë pagesë janë regjistruar edhe pagesat që janë bërë furnizim me derivate edhe për vetura.

Konkluzioni

Pagesat dhe regjistrimet në kode të gabuara ekonomike janë çështje që duhet të kenë një trajtim më të kujdesshëm, për arsye se gabimet e tilla shkaktojnë pasqyrim të paqartë të shpenzimeve.

Regjistrimi i shpenzimeve kapitale si mallra dhe shërbime, ndikon në nënvlerësimin e pasurive dhe mbivlerësimin e shpenzimeve në kategoritë tjera, si dhe në hartimin final të pasqyrave financiare.

Rekomandimi 7

Rekomandojmë Rektori e UP të siguroj:

- Forcimin e kontrolleve mbi çertifikimin e pagesave, në mënyrë që të parandaloj ekzekutimin e tyre, duke u siguruar se ekzistojnë të gjitha dëshmitë përkatëse; dhe
- Rishikimin dhe vlerësimin e procesit të pagesave, në mënyrë që të gjitha pagesat të bëhen sipas kodeve përkatëse të përcaktuara nga Thesari.

6.3 Pasuritë

6.3.1 Trajtimi i pasurive kapitale dhe jo-kapitale

Pasuritë jo qarkulluese të UP të paraqitura në PVF-të 2011 janë në vlerë 18,011,807€.

UP ka instaluar një program integruar për regjistrimin e të gjitha pasurive. Megjithatë, ende nuk ka arrit të ketë regjistër të plotë dhe të saktë për pasuritë, në veçanti pronat e paluajtshme. Sipas zyrtarëve të UP-së, edhe më tej kjo ndodhë për shkak se disa prona të UP-së janë të regjistruara si pronë e komunave dhe UP ende nuk ka mund të rregulloj çështjet pronësore.

Zyrtari i pasurisë së UP-së ka paralajmëruar Njësitë Akademike për formimin e komisioneve për regjistrim dhe inventarizim të pasurive. Megjithatë, raporti për Inventarizim të pasurisë nga njësitë akademike akoma nuk ishte përfunduar.

Konkluzioni

Mungesa e një regjistri të saktë dhe të plotë mbi të dhënat e pasurisë, i bën të pa mundur menaxhmentit të UP të paraqes një pasqyrë reale mbi pasuritë dhe aplikimin e kontrolleve adekuate.

Rekomandimi 8

Rekomandojmë Rektorin e UP të siguroj:

- Rregullimin e çështjeve pronësore me komunat për njësitë akademike që ende formalisht janë pronë e komunave dhe pronësia ligjërisht të bartet tek UP; dhe
- Regjistrimin e të gjitha pasurive të UP në pajtim me kërkesat e UA nr. 21/2009 mbi menaxhimin e pasurive qeveritare.

6.4 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e obligimeve të pa paguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2011 ishte 181,332€. Këto obligime barten për pagesë në vitin fiskal 2012.

Obligimet e bartura kanë të bëjnë me shërbime, furnizime dhe mirëmbajtje të ndryshme që kanë ndodhur në fund të vitit. Shumica e faturave, janë pranuar pas datës së mbylljes së afatit për pagesë.

Të pagueshmet e UP-së kryhen nga departamenti i Financave. Ky departament është përgjegjës për verifikimin e saktësisë të dokumentacionit të pranuar nga departamentet tjera. UP nuk ka ende një regjistër të plotë të faturave sa i përket furnitorëve, si dhe nuk kryen vlerësimin e vjetërsisë së borxheve.

Menaxhimi i detyrimeve kontingjente

Detyrimet në shumë prej 677,333€ dhe 10,928€, janë paguar drejtpërdrejt nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore. Shuma e paguar në vitin 2011 në vlerë prej 677,333€ kishte rrjedhë si detyrim kontingjent që nga viti 2008. Pra, pasqyrat financiare nuk kanë qenë konsistente prej vitit 2008 deri në vitin 2011.

Detyrimet e paguara në bazë të vendimit të Gjyqit nuk ishin prezantuar dhe shpalosur në pasqyrat financiare të viteve paraprake si detyrime kontingjente.

Konkluzioni

UP në fund vitin 2011 nuk ka qenë në gjendje të identifikoj dhe menaxhoj me kohë obligimet e papaguara. Mos përditësimi i plotë i pagimit të faturave të pranuar para mbylljes së afatit për pagesë, ka bërë që kjo të ketë efekt në buxhetimin e shpenzimeve të vitit vijues. Përcjellja e vjetërsisë së faturave do të parandaloj dënimet në rastet e vonesës së pagesave.

Detyrimet kontingjente UP-në e kanë sjellë në vështirësi të pa pritura financiare. Në mënyrë që t'i shmangët proceseve të tilla, UP duhet të merr të gjitha masat në identifikimin dhe evitimin e detyrimeve kontingjente.

Rekomandimi 9

Rekomandojmë Rektori e UP të siguroj:

- Se detyrimet e papaguara janë regjistruar në regjistrat kontabël dhe janë prezantuar drejtë dhe saktë në pasqyrat financiare;
- Detyrimet e papaguara duhet të shpalosen, të vlerësohen dhe të buxhetohen për vitin vijues; dhe
- Vlerësim në baza të vazhdueshme të gjendjes së detyrimeve të pa paguara, duke i dhënë prioritet pagesave sipas vjetërsisë së tyre.

6.5 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor

UP ka përmbushë obligimet aktuale për raportim të jashtëm si:

- Kërkesat Buxhetore janë bërë me kohë;
- Raportet financiare janë dorëzuar çdo tremujor tek MF gjatë vitit 2011;
- Pasqyrat financiare nëntë mujore të dorëzuara me kohë;
- Draft Plani i prokurimit ishte kryer me kohë, dhe ai përfundimtar. Po ashtu, i njëjti ishte dorëzuar me kohë në Autoritetin Qendror të Prokurimit;
- Raportet mbi borxhet janë dorëzuar me kohë në MF;
- Nuk ishte përgatitur raport i performancës për vitin 2011;
- Raporti mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit, nuk ishte i kryer; dhe
- UP ka miratuar një Plan Veprimi i cili i adreson rekomandimet e dhëna nga raporti i auditimit për vitin financiar 2010.

Konkluzioni

Përkundër përparimit të bërë nga UP në fushën raportimeve brenda kornizës kohore si dhe aktiviteteve të shtuara raportuese, kemi vërejtur se raportet e kontrolleve të brendshme të njërive të UP-së ende nuk kanë një shkallë të kënaqshme. Nevoja për raporte cilësore dhe në baza të rregullta, forcon kontrollin e aktiviteteve dhe lehtëson vendimmarrjen menaxheriale në të gjitha nivelet.

7 Kontrolli menaxherial

7.1 Sistemet e kontrollit të brendshëm

Kontrollet e dizajnuara paraqesin një bazë të mirë dhe shtrihen në të gjitha njësitë. Në implementimin e kontrolleve, UP edhe më tej nuk ka arrit të konsolidohet dhe funksionimi i kontrolleve mbetet dukshëm për t'u përmirësuar. Nuk vërehen ndryshime të mëdha tek planifikimet dhe kontrollet buxhetore. Buxheti i pa shpenzuar prej 6% ngrit nevojën për një qasje më të hollësishme me rastin e hartimit të kërkesave buxhetore.

Mos harmonizimet e rregullta të të hyrave kishin si pasojë mos inkasimin e plotë të të hyrave. Kontrollet e brendshme aktuale mbi të hyrat nuk janë mjaft efektive dhe nuk e sigurojnë menaxhmentin e UP-së se ato menaxhohen në mënyrën e duhur.

Ekzistojnë dyshime për pagesa të falsifikuara. Kontrollet lidhur me këto pagesa ishin të mangëta në mënyrë që t'i parandalojnë këto dukuri. Ne presim nga menaxhmenti që këto raste t'i trajtoj me një kujdes të veçantë, për të identifikuar shkaqet, nivelin dhe arsyet prapa kësaj.

Shpenzimet për projekte kapitale prej 58% vetëm në dy muajt të fund vitit, tregojnë për vonesat në zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe planifikimin jo të mirë të rrjedhës së parasë. Ky fluks i madh pagesash shkakton pasiguri nëse kontrollet e duhura janë zbatuar si dhe vë në pikëpyetje rregullsinë e tyre.

Mangësi të kontrollit të brendshëm janë vërejtur edhe në aspektin e procedurave të rekrutimit të stafit. Ky proces është zhvilluar në mungesë të kriterëve të kërkuara për pozitat përkatëse, siç janë: përvoja e punës, dëshmitë mbi përgatitjen adekuate shkollore dhe referencat për fusha përkatëse. Parregullsitë me rastin e rekrutimit të stafit janë përcjellë edhe me ankesa në KPM nga një aplikant për këtë pozitë. KPM ka shqyrtuar kërkesën e aplikuesit dhe e ka aprovuar si të bazuar. Sipas vendimit të KPM Nr. 02/215/2011 është anuluar vendimi i UP-së lidhur me përzgjedhjen e kandidatit aktual. Megjithatë, në UP kandidati i përzgjedhur ende është në funksion të detyrës.

Përveç kësaj, kontrollet e prokurimit nuk duken efektive. Edhe më tutje vazhdon kontraktimi i projekteve në mungesë të sigurimeve për ekzekutimin e kontratave.

Procesi i çertifikimit të pagesave është përcjellë me mangësi. Ngritja e masave të kontrollit është e nevojshme.

UP nuk ka ushtruar kontrolle të mjaftueshme mbi shpenzimet e telefonisë fikse, gjë që ka rezultuar me një shumë të tejkalimeve mbi limitet e lejuara.

Diferencat e dukshme ndërmjet pagës bazë dhe pagesave shtesë, duhet të analizohen dhe korrigjohen.

Mungesa e regjistrimeve të pasurive në fund të vitit dhe barazimet e gjendjes me regjistrat kontabël, bëjnë të pa mundur hartimin e një regjistri final të pasurive fikse të UP, dhe rrjedhimisht edhe menaxhimin efektiv të tyre.

Në përgjithësi, konsiderojmë se niveli i kontrollit financiar kërkon përmirësim. Kontrollat ekzistuese nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme se objektivat e menaxhmentit përmbushen në mënyrë të mjaftueshme.

7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm

Një nga objektiva e Auditimit ishte të vlerësohet pavarësia dhe cilësia e punës së NJAB për të përcaktuar nëse puna e auditorit të brendshëm i ndihmon menaxhmentit në bërjen sa më funksionale të kontrolleve të brendshme dhe vlerësimin e tyre të vazhdueshëm.

UP që nga Nëntori i vitit 2010 ka mbetur pa Auditor të Brendshëm deri në Shtator të vitit 2011. Pastaj ka të punësuar një auditor i cili gjatë kësaj periudhe kishte finalizuar vetëm një Raport të Auditimit. Ky raport kishte të bënte me Procedurat e menaxhimit të shpenzimeve të automjeteve dhe mirëmbajtja e tyre për periudhën shtator 2011-shkurt 2012. NJAB edhe më tej ka staf të limituar për të monitoruar të gjitha aktivitetet e UP-së.

Komiteti i Auditimit ishte i themeluar në UP qysh në vitin 2010, por ne nuk kemi vërejtur ndonjë kontribut të tij në zhvillimin e Auditimit të Brendshëm, pasi që nuk ka mbajtur asnjë takim pune. Qëllimi i Komitetit të Auditimit është të siguroj këshilla të dobishme për Rektorin dhe menaxhmentin e lartë të UP-së.

Konkluzioni

Konkludimi i ynë është se UP nuk i ka kushtuar vëmendje të duhur themelimit dhe funksionalizimit të NJAB. Menaxhmenti i lartë i UP është përgjegjës për zbatimin dhe funksionimin efektiv të auditimit të brendshëm.

Mos funksionimi i NJAB në një periudhë, është një mangësi në biznesin e UP-së. Rrjedhimisht, menaxhmenti nuk ka arritur të vendosë objektiva në sigurinë se gabimet dhe parregullsitë identifikohen, parandalohen dhe korrigjohen në baza të vazhdueshme.

Mos mbajtja e takimeve të rregullta pune si dhe mungesa e informimit të anëtarëve të Komitetit mbi rolin dhe përgjegjësitë e tyre, gjithsesi shfaqet si sfidë në vete dhe ngrit nevojën e diskutimeve të këtij problemi.

Rekomandimi 10

- Rekomandojmë Rektorin e UP të siguroj:
- Funksionalizimin e NJAB në kuptimin e numrit të mjaftueshëm të auditorëve; dhe
- Se komiteti i auditimit do të jetë më aktiv dhe do të mbaj takime të rregullta pune për të siguruar mbikëqyrje të duhur të planeve dhe rezultateve të auditimit dhe për të siguruar që rekomandimet e auditimit janë adresuar si duhet.

8 Një konkluzion i përgjithshëm mbi menaxhmentin e UP-së

Konkluzionet e përgjithshme

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se UP akoma nuk ka arrit të konsolidoj kontrollet e përgjithshme. Menaxhmenti duhet në mënyrë sistematike të inkurajoj vendosjen e kontrolleve të brendshme dhe të ngrit vetëdijen për nevojën e kontrolleve, veçanërisht në fushat ku dështimet janë të dukshme.

Fakti se nga tetë rekomandimet e dhëna vitin e kaluar, asnjë nuk ishte adresuar plotësisht, është një tregues se gatishmëria për të ndërmarrë veprime përmirësuese mungon. Gjithashtu, edhe opinioni i kualifikuar i auditimit për vitin 2010, nuk ka tërhequr vëmendjen e menaxhmentit për të ndërmarr veprimet e duhura përmirësuese.

Brengosje është edhe funksionalizimi i NJAB, si dhe fuqizimi i Komitetit të auditimit. Lidhur me këto, menaxhmenti duhet të ketë një qëndrim shumë më pozitiv.

Meqenëse UP ka një shtrirje të gjerë fushëveprimi, sistemi i informacionit mes UP dhe 17 njësisive të tij Akademike, duhet të jetë më i zhvilluar në aspektin e raportimit. Psh. Sistemi i harmonizimeve mujore të të hyrave, regjistrimi i pasurisë duhet të jetë i integruar.

Çështja e informimit dhe komunikimit duhet të intensifikohet edhe tek sektorët tjerë të organizatës, si: raportimi i ekzekutimit të buxhetit, realizimi i projekteve kapitale, raportet mbi regjistrimin e pasurive, etj.

Dobësitë e menaxhimit financiar vërehen edhe tek regjistrimi dhe raportimi i detyrimeve të pa paguara. Për tri vite me radhë, një detyrim kontingjent prej 677 mijë euro, nuk ishte raportuar fare në pasqyrat vjetore financiare.

Një ngritje e transparencës është e nevojshme në zhvillimin e procedurave të rekrutimit të stafit. Dokumenti bazë që do të ndihmonte përmirësimet menaxheriale dhe kontrollet është aplikimi i KBFP. Me kërkesat e këtij dokumenti duhet të njihet edhe stafi menaxhues, por edhe stafi tjetër. Ky dokument inkorporon parimet e menaxhimit financiar dhe kontrolleve, dhe si i tillë duhet të përvetësohet nga të gjithë.

Rekomandimi i Përgjithshëm

Ne rekomandojmë Rektorin e UP-së që të siguroj:

- Revitalizimin e qasjes së përgjithshme të MFP-së. Mjeti i vetëvlerësimit të Qeverisë për MFP shërben si pikënisje për Planin e Veprimit për adresimin e dobësive të përcaktuara;
- Organizimin e një projekti për implementimin e Planit të Veprimit. Të caktohet një menaxher i projektit. Menaxheri i Projektit ti raportoj drejtpërdrejtë Rektorit;
- Plani i Veprimit duhet të jetë Specifik, i Matshëm, i Arritshëm, Relevant dhe me Kohë (modeli SMART).

Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga SNISA 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);

b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;

c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;

d) është një shpalesje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifikë të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalesjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimin apo edhe të paqartësive që ngritin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionit i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionit i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit të mëhershëm

Tabela 1: Rekomandimet e vitit të mëhershëm

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Plotësisht të adresuara	Pjesërisht të adresuara	Të pa adresuara
1. Cilësia e informatave	Regjistër të plotë të pasurive të UP-së dhe shpalosjen e tyre; <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim dhe regjistrim të saktë të shpenzimeve në kodet dhe destinimet përkatëse; dhe • Informata të mjaftueshme lidhur me gjitha shpenzimet e ndodhura. 			X
2. Të hyrat vetjake	Ruajtjen dhe dosjimin e fletëpagesave burimore dhe dokumenteve tjera me të cilat dëshmohet burimi i saktë i të hyrave të inkasuara në llogari të UP-së; dhe <ul style="list-style-type: none"> • Harmonizimet në baza mujore për të hyrat vetjake në mes të njërive akademike dhe administratës qendrore të UP-së. 		Hormonizimet në baza mujore nuk ishin realizuar.	
3. Blerjet tjera	Angazhimet dhe kontratat të bëhen konform legjislacionit në fuqi; <ul style="list-style-type: none"> • Transparencë dhe konkurrencë të mirëfilltë edhe për angazhimet me kontratë mbi vepër; • Marrëveshje-kontratë me kompaninë për ngrohje "Termokos" duke definuar të gjitha komponentët e nevojshme; dhe • Raporte për ditët kur nuk ka furnizim me ngrohje, nga të gjitha njësitë akademike. 		Marrëveshje-kontratë me kompaninë për ngrohje "Termokos" duke definuar të gjitha komponentët e nevojshme ishte realizuar	

4.Kompenzi met (pagat dhe mëditjet)	<p>Forcim të kontrolleve tek menaxhimi i burimeve njerëzore;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përditësim të dosjeve të personelit dhe listës së pagave; • Zbatim të ligjeve gjatë procesit të rekrutimit të punonjësve të rinj, përfshirë këtu edhe rekrutimin për pozita menaxhuese; • Vlerësim me kohë për punën vjetore të anëtarëve të stafit; dhe • Procedimin e pagesave mbështetur në kontratat valide të marrëdhënies së punës. 			X
5.Subvencion et dhe transferet	<p>Respektim të përpiktë të memorandumit të nënshkruar me MEF; dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpenzimin e mjeteve për qëllimet e dedikuara 		Shpenzimi i mjeteve nga subvencionet ende ka mangësi.	
6.Pasuritë kapitale dhe jo kapitale.	<p>Rregullimin e çështjeve pronësore me komunat për njësitë akademike që ende formalisht janë pronë e komunave dhe pronësia ligjërish të bartet tek UP; dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimin e të gjitha pasurive të UP në pajtim me kërkesat e UA nr. 21/2009 mbi menaxhimin e pasurive qeveritare. 			X
7. Borxhet	<p>Shfrytëzim ekonomik, efikas dhe efektiv të fondeve; dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pagesën për furnizimet apo shërbimet e kryera në të mirë të UP, në afatin e paraparë ligjor. 			X
8.Auditimi i Brendshëm	<p>Themelimin e NJAB me numër stafi adekuat për madhësinë e UP;</p> <ul style="list-style-type: none"> • NJAB në planet e auditimit të përfshijë fusha me rreziqe të larta dhe të fokusohet në vitin aktual; dhe • Themelimin e Komitetit të auditimit. 		Themelimin e Komitetit të auditimit, ishte realizuar.	